



## REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA LEZHE

Bashkia; Lagjia "Skenderbeg", sh. "Gjergj Kastrioti", Lezhë - ALBANIA tel/fax: 003552152270/ 2219 e-mail: [mayor@lezha.org](mailto:mayor@lezha.org).

### FAZA E II E INVESTIMIT T ZYR S ME NJ NDALES N BASHKIN LEZH ( FINANCUAR NGA DLDP )

**Titulli i Projektit:** "Ndërtimi i zyrës me një ndalesë në Bashkinë Lezhë"

**Shuma totale e  
investimit HSI &  
NJQV**

**35 608 €<sup>1</sup> ose 4 996 218 ALL**

**Kontributi i HSI  
përmes Programit për  
Zhvillim Lokal dhe  
Decentralizim (HSI  
Shqipëri)**

**30 267 € = 4 246 785 ALL**

**Kontributi i Bashkise**

**5 341 € = 749 433 ALL  
ose 15% e shumës totale të investimit**

**Periudha e  
Marrëveshjes**

**24 Korrik – 30 Nëntor 2013**

### **CILAT JANË MANGËSITË NË INFRASTRUKTURËN E SOTME TË OSSH:**

Ndërtimi i zyrës me një ndalesë në Bashkinë Lezhë është parashikuar në dy faza. Në fazën e I u investua nga buxheti i Bashkisë një fond prej 3'640'000 lekë, të cilat kanë shkuar për investim në infrastrukture (për punimet në përshtatjen e zyrës, moblijet e objekte të tjera të nevojshme).

Theksojmë se nuk është ndërhyrë në infrastrukturën kompjuterike të zyrës me një ndalesë. Janë përdorur kompjuterat ekzistentë të zyrove të Bashkisë të cilët janë të amortizuar në maksimum nga vitet e shumta të përdorimit dhe nuk janë në gjendje të mirë pune. Përdorimi i kësaj teknologjie të vjetëruar dhe të amortizuar pengon realizimin e kërkesave të qytetarëve me më efikasitet.

<sup>1</sup> Kursi i këmbimit të EUR / LEK është referuar kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, dt 22.07.2013 1 € = 140.35 ALL

Aktualisht vetëm Drejtoria e Taksave dhe Tarifave vendore disponon një soft kompjuterik optimal për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve në mënyrë automatike. Të gjitha drejtoritë e tjera punojnë vetëm me programet e Paketës Office dukë e realizuar gjithë procesin e punës në menyrë manuale, dhe duke u spostuar fizikisht nga zyra në zyrë për të komunikuar me kolegët.

Për përmirësimin e shërbimit si nga front office ashtu edhe nga back office ndihet nevoja e instalimit të softeve të personalizuar për ofrimin e produkteve të bashkisë, në mënyrë që qytetarët të marrin të gjitha shërbimet e kërkuara në një kohë të shkurtër dhe pa humbur kohë dukë pritur punonjësit që lëvizin nga zyra në zyrë për tju ofruar qytetarëve këto shërbime.

Me kërkesë të Bashkisë Lezhë për vijimësi të perfeksionimit të punës dhe shërbimit që kjo zyrë ofron në komunitet me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit duke rritur kapacitet e stafit të bashkisë dhe përmirësuar infrastrukturën dhe teknologjinë, DLDP merr përsipër të mbështesë finaciarisht kërkesën e Bashkisë Lezhë për fazën e II, në zërat si më poshtë:

Ky projekt mundëson:

**I. Rikonstrukcion zyrash (mobilim, infrastrukture, intranet) =1 155 280 Lekë**

Tenderohet nga Bashkia Lezhë (Bashkëngjitur do të gjeni preventivat përkatës)

**II. Asistencë teknike stafit dhe takimeme komunitetin (flag). == 1 811 638 Lekë (ekspertët janë selektuar direkt nga donatori, DLDP)**

**III. Asistencë teknike dhe blerje modulesh (ARK it). =1 137 640 Lekë** (ofruesi i këtij shërbimi është selektuar direkt nga donatori, pasi ka ofruar me cilësi këtë shërbim dhe në bashki të tjera me parë finacuar nga DLDP)

Modulet që mundëson ky projekt:

1. MODULI i Kërkesë Ankesave për përdorim në rrjet dhe/apo online
2. MODULI i Ndihmës Shoqërore për përdorim në rrjet dhe/apo online
3. MODULI i Librarisë Ligjore për përdorim në rrjet dhe/apo online
4. MODULI i Taksave për përdorim në rrjet dhe/apo online
5. MODULI i E-pjesëmarrje për përdorim në rrjet dhe/apo online
6. SISTEMI KOMPJUTERIK - Konfigurimi i kompjuterave/MODULEVE i përzgjedhur nga Klienti.

**IV. Blerje pajisje (komputera, printer, fotokopje) = 891 660 Lekë**

Tenderohet nga Bashkia Lezhë (Bashkëngjitur do të gjeni preventivin)

**CFARE DO PËRMIRESOHET NË OSSH NËPËRMJET INVESTIMIT TE RI:**

OSSH është konceptuar si një vend ku pranohen kërkesat, ankesat dhe aplikimet për shërbimet e ndryshme të konsumatorëve, më pas përpunohet (duke ju adresuar zyrave prodhuese për të ndjekur procedurat e duhura administrative brenda zyrës përkatëse të shërbimit) dhe kthehen më pas te kërkuesi.

Nëpërmjet këtij investimi do të përmirësohen ndjeshëm:

- Komunikimi online midis front office dhe back office për ofrimin e shërbimeve në kohë sa me optimale për qytetarët dhe në transparencë të plotë.
- Marrëdhëniet e Bashkisë me qytetarët e saj, aftësitë e qeverisjes, kulturën dhe proceset e punës, duke mundësuar realizimin e një demokracie vendore dhe një qeverisje pjesëmarrëse të avancuar nepermjet rritjes së kapaciteteve të stafit si dhe informimin e komunitit në të njëjtën kohë.
- Përmirësimi i teknologjisë, rritja e kapacitetit të serverit që disponon aktualisht Bashkia (Serveri momentalisht ka të inkorporuar një Hard Disk me kapacitet 140 GB, i cili është shumë i pamjaftueshëm për të përballuar punën e parashikuar, por mund të shtohen dhe 3 Hard Disqe të tjerë me kapacitet të ndryshëm), blera e kompjuterave të rinj e me parametra bashkëkohorë, instalimi i moduleve të personalizuar për ofrimin e shërbimeve do rrisë dukshëm produktivitetin e OSSH.
- Njëkohësisht do të përmirësohet ndjeshëm faqja web e bashkisë, nëpërmjet ristrukturimit të dizajnit dhe përmbajtjes në mënyrë që të përshtatet më mirë kërkesave të fazës së re që hyn bashkia në lidhje me komunikimin, ofrimin e shërbimeve dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në mënyrë të automatizuar.